



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Qershor 2021

Nr. 387

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku
- Kërkues:** Qytetar
- Ndaj:** Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I**

**Vlerësimi paraprak**



Data: 09 Qershor 2021  
Nr. 387

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1396 prot., datë 19.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3986 prot., datë 19.04.2021, nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm zj. Ornela Zonja, është përcjellë denoncimi i mbërritur në mënyrë shkresore pranë këtij institucioni nga z. Alfred Alstefa. Në këtë denoncim pretendohet se: *“Subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë, me në krye zj. Belinda Balluku po shtrojnë asfalt pa projekt dhe pa asnjë kriter dhe në kundërvajtje me ligjin”*. *Bashkangjitur këtij denoncimi është paraqitur denoncimi i dërguar nga z. Alfred Alstefa i datës 16.04.2021 ora 09:39 a.m, i dërguar pranë portalit “Denonco” pranë Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.*

Denoncuesi kërkon verifikimin dhe hetimin e rastit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 7, të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, datës së kallzimit dhe ndalimeve të parashikuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Përsa i përket pretendimit të denoncuesit se kryerja e këtyre punimeve është duke u kryer pa asnjë projekt, kriter dhe në kundërvajtje me ligjin, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se hetimi për këto të dhëna del jashtë kompetencës së tij lëndore dhe vendos të shpallë moskompetencën në lidhje me këto kërkitime.

## II

### Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në kallëzimin nr. 1396 prot., datë 19.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3986 prot., datë 19.04.2021, pretendohet se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka filluar kryerjen e punimeve në rrugën “Shaban Bardhoshi” në Tiranë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerësoi të arsyeshme kryerjen e hetimeve administrative.

Rezultoi e provuar se rehabilitimi i rrugës “Shaban Bardhoshi” dhe kanalit pranë kësaj rruge ka nisur para datës 21.11.2020. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku nëpërmjet një aktiviteti publik në njësisë administrative nr. 6 Tiranë, ka kryer inspektimin e punimeve në këtë zonë.

## III

### Analiza ligjore



Referuar pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, “Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose **Ministrit**, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zoteron aksione e kapitale/kuota apo emeron shumicën e organit mbikqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Ministri është subjekt i këtij vendimi.

Referuar nenin 2, shkronja “b” të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcakton se veprimtari publike janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Referuar nenit 3, pika 1, nënndarja 1.1 “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë **veprimtaritë publike** sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë **vënë rishtazi** apo **posaçërisht në dispozicion**, apo janë **transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve** dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;...
- ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.

Lidhur me rastin objekt kallëzimi, punimet për rehabilitimin e rrugës “Shaban Bardhoshi” dhe kanalit kullues kanë nisur në datën 21.11.2020. Vendimi nr. 9/2020 përcakton se veprimtari të ndaluara janë ato veprimtari publike për të cilat janë **vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion**, apo janë **transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të



transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar, pasi punimet kanë nisur para miratimit të këtij vendimi. Vlerësoj të rëndësishme të theksohet se, referuar denoncimit të mësipërm, kryerja e punimeve për rehabilitimin e rrugës dhe kanalit kullues, **është në përmbushje të detyrimeve kontraktuale të lindura para hyrjes në fuqi të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.**

Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “a” ... *mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut dhe shkronjës “ç”... mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi, duhet që fondet e përdorura për promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur **rishtazi apo posaçërisht në dispozicion** dhe të ishin transferuar **jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Këto janë kushte komulative të përcaktuara nga neni 3, dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra.*

Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Blluku është në shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga kallëzuesi pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e këtij institucioni, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë zj. Belinda Balluku, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



2. Të shpall moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesave të tjera.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 09 Qershor 2021  
Nr. 387

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku